



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr. 97 prot.

Kamëz, më 30.06.2022

V E N D I M  
Nr. 83. Datë 30/06 2022  
MBI

**“PJESMARRJEN E BASHKISË KAMËZ NË SUBJEKTE ME KOMPETENCA TË PËRBASHKËTA ME QËLLIM KRYERJEN E SHËRBIMEVE TË FURNIZIMIT ME UJË TË PIJSHËM, GRUMBULLIMIT, LARGIMIT DHE TRAJTIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA”**

Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot me datë 30.06.2022, pasi mori në shqyrtim projekt-vendimin Nr.72 Datë 30.06.2022 në mbështetje të nenit 113, të Kushtetutës; të nenit 9, dhe të pikës 1 dhe 5, të nenit 14 e vijues të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore”, të ndryshuar; të Ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar; Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.302, datë 11.05.2022 “Për politikat kombëtare për riorganizmin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit, dhe të përpunimit të ujrave të ndotur ”; **Këshilli Bashkiak Kamëz”;**

**V E N D O S I :**

1. Miratimin për autorizimin e Kryetarit të Bashkisë, në përputhje me Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore”, për të negociuar me shoqëritë publike të Ujësjetës Kanalizimeve që aktualisht ushtrojnë shërbime të furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura në Republikën e Shqipërisë si dhe Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë për mundësinë lidhjen e marrëveshjes specifike për krijimin e “Subjektit të Kompetencave të Përbashkëta”, për kryerjen e veprimtarisë së mësipërme në zonat e shërbimit.
2. Autorizimin e Kryetarit të Bashkisë në cilësinë e tij si përfaqësues Aksionar i vetëm i Shoqërisë Aksionare Ujësjetës-Kanalizime Kamëz, që pas krijimit të “Subjekteve me Kompetenca të Përbashkëta” ku Bashkia do të jetë aksionare, të vijojë me miratimin në Asamblenë e Përgjithshme të Aksionareve të autorizimit për Administratorin e Shoqërisë Aksionare Ujësjetës - Kanalizime Kamëz për nënshkrimin e çdo akti të nevojshëm kontraktore dhe noterial me qëllim transferimit të veprimtarisë ekonomike për tek shoqëria e re SKP-UK që do të krijohet.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë Kamëz.
4. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55 të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar.
5. Ky vendim hyn në fuqi pas **konfirmimit ligjor nga Prefekti i Qarkut Tiranë.**

**Nën/Kryetar Këshilli**

**Ali DAUTI**

